

Termet e Referencës:

Mirëmbajtja e uebfaqes së SOS Fshatrave të Fëmijëve në Kosovë

1. Rreth SOS Fshatrave të Fëmijëve

Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve është organizatë joqeveritare e përkujdesjes sociale e dedikuar për përkrahjen e fëmijëve të braktisur dhe nevojtarë pa marrë parasysh etninë, kombësinë dhe besimin fetar. Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë vepron nga viti 1999 dhe deri tani është përkujdesur për mbi 1300 fëmijë të braktisur, pa përkujdesje prindërore dhe nevojtarë. Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, aktualisht ofron strehim, përkujdesje, edukim dhe përkrahje për afër 1000 fëmijë përmes 3 Pogrameve:

- ▶ **Kujdesi alternativ për fëmijë pa kujdes prindëror** – aktualisht përmes 7 SOS Familjeve ofron përkujdesje për 37 fëmijë të braktisur dhe fëmijë pa përkujdesje prindërore të moshës 0 -18 vjeçar
- ▶ **Programi i gjysëpavarësisë** – aktualisht përkrahë 13 të rinjë pa përkujdesje prindërore të moshës mbi 19 vjeç
- ▶ **Programi i Fuqizimit të Familjes** – ofron shërbime të integruara psikologjike dhe sociale Në 3 lokacione të Kosovës dhe aktualisht përkrahë 963 fëmijë dhe të rinjë në rrezik të braktisjes dhe familjet e tyre.

2. Fushëveprimi i angazhimit

SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë është duke kërkuar shërbimet e një kompanie që të mirëmbajë dhe avancojë uebfaqen e organizatës: (www.soskosova.org). Uebfaqja është e ndërtuar në WordPress. Funkcionet kryesore të ueb-it janë:

- Informimi mbi punën e organizatës,
- Mbledhja e fondeve përmes shërbimit të e-commerce,
- Aktivitetet, publikimet dhe bashkëpunimet me partnerët dhe donatorët.

Nën drejtimin e ekipit të SOS Fshatrave të Fëmijëve në Kosovë, nga ofruesi i shërbimeve do të pritet që ti realizojë detyrat si në vijim:

- ✚ **Mirëmbajtja teknike e uebfaqes:** Kjo përfshin përditësimin e përmbajtjes (postimin), zgjidhjen e gabimeve, dhe sigurimin e funksionimit të saktë të uebfaqes.
- ✚ **Përkrahje e specializuar:** Kjo përfshin përgjigjen në pyetjet e përdoruesve, zgjidhjen e problemeve teknike dhe ofrimin e ndihmës në navigim në uebfaqe.
- ✚ **Përmirësime vizuale:** Kjo përfshin propozimin dhe zbatimin e përmirësimeve në dizajn, funksionalitet dhe përmbajtje të uebfaqes.

- ✚ Sigurimi i uebfaqes: Kjo përfshin marrjen e masave për të mbrojtur ueb faqen nga sulmet kibernetike dhe aksesin e paautorizuar.
- ✚ Raportim dhe analizë: Kjo përfshin ofrimin e raporteve të rregullta mbi performancën e uebfaqes dhe trendet e përdorimit.

3. Kohëzgjatja e angazhimit

Kohëzgjatja e detyrës

Kohëzgjatja e kontratës dhe ofrimit të shërbimeve do të jetë për një periudhë tetë (8) mujore pas nënshkrimit të kontratës. Kompania e përzgjedhur do të ofrojë përkrahje 24/7 rreth çështjeve teknike të uebfaqes.

Caktimi i sesionit informues

Takimi i pare do të caktohet për ekipin e SOS Fshatrave të Fëmijëve në Kosovë për informimin e zhvillimit të secilës kërkesë

Ofruesi i shërbimeve do të punojë drejtpërdrejtë në konsultim dhe nën mbikëqyrjen Ekipit për Mbledhje të Fondeve dhe personit përgjegjës për komunikim në SOS Fshatrave të Fëmijëve në Kosovë

4. Aftësitë dhe eksperiencia e kërkuar

Ofruesi duhet të demonstrojë dhe të sigurojë shembuj të përvojave paraprake në shërbime të ngjashme si në vazhdim:

- ▶ Të jetë kompani me reputacion dhe së paku tre (3) vjet të përvojës paraprake në dizajnimin e uebfaqeve tërheqëse për sy dhe lehtë të manovrueshme
- ▶ Njohuri dhe përvojë relevante në përdorimin e “Content Management Systems (CMS)”, veçanërisht e WordPress;
- ▶ Të kenë njohuri të shkëlqyeshme të trendeve të fundit në dizajn grafik, përfshire publikim të videove online si dhe në rrjetet sociale.
- ▶ Të demonstrojë aftësi dhe të krijojë dizajn inovativ dhe vizuelisht tërheqës;
- ▶ Kualifikimi i stafit profesional dhe kompetencat që duhen për këtë detyrë;

5. Orari i Pagesave dhe Afati Kohor

Pagesat do të bëhen në baza mujore për një afat tetë (8) mujor që nga data e nënshkrimit të kontratës.

6. Dokumentet që duhet të përfshihen në propozim

Në rast se i posedoni kualifikimet e kërkuara dhe jeni të interesuar në këtë kontratë, ju lutem dorëzoni:

- ▶ Qertifikata e regjistrimit te biznesit/ NUI
- ▶ Qmimet e kuotuar në euro pa tvsh
- ▶ Oferta financiare e nënshkruar ose me llogo zyrtare
- ▶ Portfolio e kompanisë e cila e përshkruan punët e ngjashme të mëparshme, përbërjen e ekipit.
- ▶ CV-jat e ekipit që do të angazhohet.
- ▶ Ofertë financiare për shërbimin për një muaj.

7. Procesi i Vlerësimit dhe Përzgjedhjes

Ofertat do të vlerësohen bazuar në kriterët e mëposhtme të vlerësimit:

Kriterët e Vlerësimit – Gjithsejtë 100 pikë

- ▶ Portfolio e prezentuar nga kompania do të vlerësohet për kualitetin e punës që kompania ka ofruar në të kaluarën (25 pikë);
- ▶ Përvoja dhe kualifikimet e ekipit të propozuar nga kompania për të kryer shërbimin e kërkuar. Kjo pjesë e vlerësimit do të bëhet bazuar në CV e individëve që do ta përbëjnë ekipin. Këto CV duhet të përfshihen nga kompania në propozimin e tyre.(20 pikë);
- ▶ Përvoja me uebfaqet në sistemin Word Press. (20 pikë);
- ▶ Përvoja e kompanisë me organizata të shoqërisë civile (OJQ) në fushën e ngjashme të kërkuar me këtë angazhim (5 pikë).
- ▶ Oferta financiare (30 pikë)

Ofertuesit e interesuar mund t'i dërgojnë dokumentet dhe ofertën e bashkangjitur në email adresën: procurement1@soskosova.org deri me datën: 29.04.2024